



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENSIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE

**RAPORT
I
ANALIZËS SË VEPRIMTARISË PËR VITIN 2018**



AGJENSIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE DHE
NDERTIMEVE INFORMALE

TIRANE, shkurt 2019

PERMBAJTJA

I. BILANCI I VEPRIMTARISË

A. TREGUESIT E ECURISË SË PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE

B. TRAJTIMI I KËRKESË ANKESAVE

C. INFORMIMI INSTITUCIONAL MBI SHËRBIMET E OFRUARA

D. SITUATA FINANCIARE, ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.

E. VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM.

II. OBJEKTIVAT

A. ECURIA E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE GJATË PERIUdhËS JANAR - DHJETOR 2018.

Mbi bazën e një studimi analitik të bërë për çdo qark, është vlerësuar se nga numri i përgjithshëm i ndërtimeve të përfshira në proces, një kontigjent prej **94.131 ndërtimesh**, nuk mund të vijojnë procedurat me legjislacionin aktual pasi nuk plotësojnë kriteret për t'u legalizuar.

Tabela 1 paraqet numrin e përgjithshëm të aplikimeve për legalizim, numrin e përgjithshëm të ndërtimeve që gjenden në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, si dhe numrin e përgjithshëm të objekteve që plotësojnë kriteret për legalizim.

Tabela nr. 1

QARKU:	APLIKIME:	OBJEKTE QE NUK LEGALIZOHEN	OBJEKTE TE LEGALIZUESHEM
BERAT	11,490	1,693	9.797
DIBËR	2,967	108	2.859
DURRËS	51,189	9,795	41.394
ELBASAN	32,925	226	32.699
FIER	39,731	9,805	29.926
GJIROKASTËR	3,710	352	3.358
KORÇË	12,709	7,216	4.493
KUKËS	2,692	747	1.945
LEZHË	16,565	4,042	12.523
SHKODËR	24,596	1,993	22.603
VLORË	26,594	10,925	15.669
TIRANË	97,916	47,229	50.687
GJITHSEJ:	323.082	94.131	228.951

1. Procesi i përditësimit (matjet) në terren të ndërtimeve informale.

Si një ndër proceset kryesore, përditësimi përfshin matjet në terren të objektit informal, evidentimin e të dhënave ndërtimore dhe pasqyrimin e tyre në proces verbalin e evidentimit. Gjatë periudhës **Janar-Mars 2018** janë kryer këto procedura për pjesën e mbetur të objekteve informale, **7.212**, duke e çuar numrin e përgjithshëm në **323.082** dhe përfundimin e këtij procesi për objektet pa leje.

Tabela nr.2 paraqet ecurinë e këtij treguesi sipas grup-viteve (2006-2013; 2014-2018) dhe për periudhën 1 janar-31 mars 2018

Tabela nr. 2

EVIDENTIMI NE TERREN			
2006-2013	2014-2017	Janar-Mars 2018	TOTAL
46.037	269.833	7.212	323.082


2. Lëshimi i lejeve të legalizimit

Gjatë vitit 2018, finalizimi i procesit në dhënien e lejeve të legalizimit ka ecur me ritme relativisht të kënaqshme, me një **mesatare mujore** prej rreth **2.500 leje**. Me performancën më të mirë paraqiten Qarku Tiranë, Fier, Durrës dhe Vlorë me respektivisht 9533; 4556, 3554 dhe 3320 leje legalizimi. Gjatë vitit 2018 janë emetuar **30.151** leje legalizimi duke **realizuar objektivin në masën 120%**, krahasuar me planifikimin vjetor prej 25.000 leje. *Tabela 3 dhe Grafiku 1*, pasqyrojnë ecurinë e këtij procesi sipas muajve të vitit 2018 në bazë qarku.

Tabela nr. 3

QARKU	JAN	SHKU	MAR	PRI	MAJ	QERSH	KORR	GUSH	SHTAT	TET	NENT	DHJET	TOTALI
BERAT	35	35	72	102	126	100	80	38	72	54	100	65	879
DIBER	44	18	39	45	52	34	56	43	25	63	26	62	507
DURRËS	80	79	117	186	275	404	367	311	399	521	541	274	3.554
ELBASAN	42	4	186	315	258	136	188	145	163	314	406	127	2.284
FIER	350	344	549	474	516	614	409	250	339	316	229	166	4.556
GJIROK.	40	60	62	49	42	46	42	27	48	47	57	47	567
KORÇË	103	157	208	190	103	87	84	89	105	135	106	98	1.465
KUKËS	1	27	39	34	31	11	13	34	31	33	40	25	319
LEZHË	76	2	269	329	272	252	250	162	162	263	220	154	2.411
SHKODËR	4	0	67	105	109	93	108	115	54	23	26	52	756
TIRANË	203	315	961	882	896	797	940	785	881	1192	1020	661	9.533
VLOBË	38	155	336	371	333	345	488	249	224	263	370	148	3.320
TOTAL	1.016	1.196	2.905	3.082	3.013	2.919	3.025	2.248	2.503	3.224	3.141	1.879	30.151

Grafiku nr.1



Numri i pritshëm i objekteve, që do të pajisen me leje legalizimi (diferenca midis “objekte të legalizueshme” dhe “leje legalizimi”) deri në përfundim të procesit është **62.206** (Tabela 4).

Tabela 4

OBJEKTE TE LEGALIZUESHEM	LEJE TE DHENA 2006-2018	OBJEKTE NE PROCES
228.951	166.745	62.206

Në Tabelën 5, pasqyrohet ecuria e procesit të legalizimit sipas viteve, ku numri më i madh i lejeve të legalizimit është në vitin 2016-**48.351**, ndërkohë numri më i vogël në vitin 2010-**1.821** leje legalizimi.

Tabela 5


LEJE LEGALIZIMI SIPAS VITEVE										
2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	TOTAL
1.583	1.821	4.006	5.769	8.571	15.294	24.748	48.351	26.451	30.151	166.745

Në tabelën vijuese (nr. 6) është paraqitur shpërndarja e numrit të lejeve të legalizimit sipas viteve, në nivel qarku.

Tabela 6

QARKU	2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	TOTALI
BERAT	113	113	420	473	258	431	477	269	807	879	4.240
DIBER	21	45	71	91	89	46	173	508	343	507	1.894
DURRES	202	247	489	803	987	3.386	5.885	12.917	4.705	3.554	33.175
EL.BASAN	266	276	361	548	620	1.553	1.007	4.671	2.554	2.284	14.140
FIER	127	149	262	562	608	2.698	2.443	6.323	3.913	4.556	21.641
GJIROKASTER	37	74	71	102	44	361	397	614	447	567	2.714
KORCA	92	85	164	321	180	152	998	780	978	1.465	5.215
KUKSI	18	54	100	127	42	291	266	187	286	319	1.690
LEZHE	101	230	316	453	327	792	1.222	3.740	1.104	2.411	10.696
SHKODER	131	159	222	510	381	1.033	1.377	3.520	694	756	8.783
TIRANA	356	276	1.136	1.177	3.521	3.371	9.623	13.023	7.089	9.533	49.105
VLORE	119	113	394	602	1.514	1.180	880	1.799	3.531	3.320	13.452
TOTALI	1.583	1.821	4.006	5.769	8.571	15.294	24.748	48.351	26.451	30.151	166.745

Grafiku nr.2




Ne Tabelen 7, pasqyrohet progresivi i lejeve te leglizimit nga viti 2006-2018, ku nga grafiku 3, dukshem shikohet rritja e ketij numri nga viti ne vit duke arritur numrin ne total 166.745 leje ne vitin 2018.

Tabela 7

PROGRESIVI I LEJEVE TE LEGALIZIMIT SIPAS VITEVE									
2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
1583	3.404	7.410	13.179	21.750	37.044	61.792	110.143	136.594	166.745

Grafiku 3



Në Tabelën 8 paraqiten lejet e përcjella për regjistrim në Zyrat Vendore të Regjistrimit, sipas qarqeve, gjatë vitit 2018.

Tabela nr. 8

QARKU	LEJET E LEGALIZIMIT TË PËRCJELLA NË ZVRPP												TOTAL
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORR	GUSH	SHTAT	TET	NENT	DHJET	
BERAT	46	13	38	69	35	103	68	65	27	82	67	47	660
DIBER	26	20	17	37	35	44	37	61	36	23	59	8	403
DURRËS	80	78	121	59	258	400	401	389	364	438	505	484	3577
ELBASAN	237	208	60	199	173	101	311	259	1709	583	229	154	4223
FIER	334	217	510	601	343	675	511	114	648	417	413	288	5071
GJIROKASTËR	38	35	67	56	53	44	45	44	28	45	50	55	560
KORÇË	170	170	184	185	182	187	108	77	108	165	143	89	1768
KUKËS	27	41	29	34	37	18	39	35	41	35	39	29	404
LEZHË	150	139	422	400	356	300	411	635	194	233	280	350	3870
SHKODËR	27	20	23	23	185	307	272	231	132	239	255	100	1814
VLORE	70	165	333	262	354	352	265	309	126	157	175	242	2810
TIRANË	455	535	668	791	1067	1480	1390	937	1343	2095	1199	1161	13121
TOTAL	1660	1641	2472	2716	3078	4011	3858	3156	4756	4512	3414	3007	38.281

3. Ndërtimet e përjashtuara nga legalizimi

Krahas procedurave të legalizimit, nga drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe **procedurat administrative të përjashtimit nga procesi i legalizimit**, për **583** ndërtime, të cilët nuk plotësojnë kushtet për legalizim, sipas ligjit nr.9482/2006 "Për legalizimin..." dhe VKM nr. 280/2014. Kryesisht iniciativa për përjashtim nga legalizimi është marrë mbi bazën e kërkesave të IMT-Vendore pranë Bashkive dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në kuadër të zbatimit të projekteve të infrastrukturës publike.

4. Kalimi i të së drejtës së pronësisë dhe kompensimi i pronarëve.

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin...", i ndryshuar, nga strukturat përgjegjëse në qarqe dhe Drejtoria e Cështjeve të Pronësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, është hartuar dokumentacioni i nevojshëm i cili ka rezultuar në miratimin nga Këshilli i Ministrave, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 të:

- Kalimit të së drejtës së pronësisë për **1.883** parcela ndërtimore, të zëna nga ndërtimet pa leje;
- Shpërblimit financiar të **4.497** subjekteve, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje, me vlerë të përgjithshme prej **3.055.151.503,0** lekë.

Aktet e hartuara nga ALUIZNI dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave për këtë qëllim, gjatë vitit 2018 janë sa vijon:

1. VKM nr.291, datë 21.05.2018 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre".
2. VKM nr.292, datë 21.5.2018 "Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara".
3. VKM nr.293, datë 21.05.2018 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre".

4. VKM nr.294, datë 21.05.2018 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”
5. VKM nr.369, datë 21.05.2018 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”
7. VKM nr.370, datë 20.06.2018 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimet informale””;
8. VKM nr.371, datë 20.06.2018 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara”
9. VKM nr.433, datë 11.07.2018 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”
10. VKM nr.737, datë 12.12.2018 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë dërguar për miratim në Ministrinë e Drejtësisë 4 projektakte për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, si dhe 3 projektakte për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat ndërtimore, të cilët nuk janë miratuar ende.

Shqyrtimi në Ministrinë e Drejtësisë dhe miratimi i projektvendimeve ka qenë gjithmonë një hallkë procedurale e ngadaltë, që jo vetëm shkakton vonesa të konsiderueshme në procesin e legalizimit, po ndikon drejtpërdrejtë dhe vë në rrezik realizimin e fondit financiar të kompensimit të pronarëve. Kjo pasi sipas parashikimeve ligjore, të ardhurat për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjenerohen nga pagesa e parcelës ndërtimore (kalimi i të drejtës së pronësisë tek subjekti që posedon ndërtimin). Këto vonesa janë bërë veçanërisht të ndjeshme në gjashtë muajt e fundit, periudhë gjatë së cilës nuk është miratuar asnjë projektvendim “Për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore” dhe vendimi i fundit është miratuar që në 11.07.2018.

Në këto kushte, nga ana e drejtorive të varësisë u ndërpre përgatitja e materialit për kalimin e parcelës ndërtimore, duke parë që nuk kalonin më për miratim projekt VKM-të e dërguara.

B. TRAJTIMI I KËRKESË ANKESAVE.

1. Të dhëna mbi kërkesë ankesat e subjekteve, për procedurat e legalizimit.

Drejtorja e Përgjithshme monitoron në mënyrë sistematike trajtimin nga drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t të kërkesave/ankesave të subjekteve të përfshirë direkt ose indirekt në procesin e legalizimit. Monitorimi konsiston jo vetëm në pasqyrimin e të dhënave numerike mbi numrin e përgjithshëm të kërkesave/ankesave të përcjella dhe të trajtuara por, edhe mbi përmbajtjen e informacionit, nëse është i plotë, shterues, i bazuar në kuadrin ligjor dhe i shoqëruar me dokumentacion provues.

Tabela 9, paraqet shpërndarjen e kërkesë/ankesave dhe numrin e rasteve të trajtuara sipas drejtorive, gjatë periudhës Janar-31 Dhjetor 2018.

Tabela 9

1 JANAR–31 DHJETOR 2018		
DREJTORIA	Dërguar	Trajtuar
Berat	7	6
Dibër	1	1
Durrës	31	10
Elbasan	21	7
Fier	17	3
Gjirokastrë	1	1
Kavajë	3	3
Korçë	11	10
Krujë	2	2
Kukës	1	1
Lezhë	4	4
Lushnje	4	2
Sarandë	11	7
Shkodër	22	4
Vlorë	39	33
Tirana Veri	220	80
Tirana Jug	130	96
Tirana 2	85	76
Tirana Rurale	42	33
Zonat Turistike	5	5
Kamëz - Vorë	31	13
TOTAL	688	397

Sipas të dhënave, drejtoritë që kanë peshën më të madhe në trajtimin e kërkesave/ankesave janë drejtoritë e varësisë të Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës.

Objekti i kërkesave/ankesave lidhet kryesisht me:

1. Përfundimin e procedurave të legalizimit;
2. Problematika në regjistrimin e lejes së legalizimit për shkak të pasaktësive në të dhënat e aktit administrativ, mbivendosjes së parcelës ndërtimore referuar hartave të zyrave vendore të regjistrimit;
3. Miratimin e VKM për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore/kompesimin e pronarit të truallit;
4. Pezullimin e procedurave të legalizimit për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me objektin në proces legalizimit ose të përfshirjes së personave të tjerë që pretendojnë të drejta mbi parcelën ndërtimore;
5. Përrjashtimin nga legalizimi në rastet e vendimeve të formës së prerë për lirim/dorëzim trualli etj.

C. INFORMIMI INSTITUCIONAL MBI SHËRBIMET E OFRUARA.

Në kuadër ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese, si dhe me prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore, ALUIZNI është

investuar në korrespondenca shkresore duke dërguar informacion, apo kopje dokumentacioni.

Sipas kërkesave të paraqitura nga këto institucione, Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t ka dërguar informacion nëse subjektet figurojnë aplikues për legalizim, apo të dhëna konkrete mbi procedurat e legalizimit në emër të tyre, si vendndodhjen e objektit pa leje, fazën në të cilën ndodhet praktika për legalizim, pagesat e kryera nga subjektet për efekt të legalizimit, etj.

Me konkretisht, janë trajtuar:

- **760 shkresa** të mbërritura nga Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI) mbi subjekte që i nënshtrohen verifikimit dhe kontrollit të të ardhurave dhe pasurive;
- **69 kërkesa** për informacion nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, mbi gjyqtarët dhe prokurorët që po i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar;
- **161 kërkesa** për informacion, apo depozitim kopje e njehsuar dokumentacioni të praktikave dokumentare, nga Prokuroria, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe Policia e Shtetit, për subjekte të cilat janë palë në procese gjyqësore civile/administrative, apo ndodhen në proces hetimi, ndjekjeje penale, apo gjykimi të veprave penale.

Ndërkaq, sipas kërkesave të mbërritura nga vetë subjektet e interesuara, këta të fundit janë pajisur me 214 vërtetime mbi fakin që janë ose jo në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t.

Tabela 10, paraqet korrespondencën me institucionet e përmendura, gjatë periudhës Janar-31 Dhjetor 2018.

Tabela 10

Shkresa të trajtuara për vitin 2018		
Nr	Institucioni	Shkresa te trajtuara
1	ILDKPI	760
2	Komisioni i pavarur i kualifikimit	169
3	Gjykatë+Përmbaremore	161
4	Prokurori+Polici	136
5	Vërtetime	214
6	Të ndryshme	91
	Totali	1531

D. SITUATA FINANCIARE, SHËRBIMET MBËSHTETËSE DHE PROKURIMET.

1. Planifikimi buxhetor.

Në mbështetje të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.7/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021", ALUIZNI ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, Faza I, për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 21 Drejtoritë e varësisë.

Në zbatim të ligjin Nr.109/2017 "Për buxhetin vitit 2018", Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë" nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kryer detajimi i fondeve buxhetore, detajimi i limiteve mujore (planit të arkës) për drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t, të cilat u miratuan nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. E njëjta procedurë u realizua edhe për numrin e punonjësve, të miratuar për Institucionin. Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësise së ALUIZNI-t, filluan vitin e ri buxhetor me fonde dhe numër punonjësish të miratuar, në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore.

Në janar të vitit 2018, janë paraqitur të argumentuara në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe te Ekonomisë **kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme**, për drejtoritë e varësisë dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej **460 punonjësish**. Për nevoja të institucionit, u ndoq e njëjta procedurë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2018 duke u shtuar një kontigjent prej 150 punonjësish me kontratë, në varësi të arkëtimit të të ardhurave.

2. Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve publike.

Drejtoria e Finances dhe Shërbimeve Mbështetëse ka bërë menaxhimin dhe monitorimin periodik të realizimit të shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t. Në përmbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht, cdo 4-mujor, raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit.

Për vitin 2018, janë administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore sipas dy programeve të miratuara e konkretisht:

- Shpenzimet
- Investimet Publike

a. Shpenzimet

Realizimi i shpenzimeve buxhetore operative "Mallra dhe shërbime", për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Planifikimi	Realizimi	%
1	Berat	1.800.000	1.467.764	81,5
2	Diber	3.449.666	3.412.793	98,9
3	Durres	4.092.525	4.000.290	97,7
4	Elbasan	4.195.520	4.192.093	99,9
5	Fier	4.652.492	4.432.699	95,3
6	Gjirokaster	1.800.000	1.510.312	83,9
7	Kavaje	1.200.000	1.117.649	93,1
8	Kruje	1.200.000	695.490	58,0
9	Korce	3.000.000	2.529.561	84,3
10	Kukes	1.800.000	1.800.000	100,0

11	Lezhe	3.000.000	2.999.870	100,0
12	Lushnje	1.200.000	929.400	77,5
13	Shkoder	3.011.135	2.743.022	91,1
14	Vlore	6.056.304	6.055.533	100,0
15	Sarande	1.800.000	1.798.910	99,9
16	Tirane Veri	4.697.874	4.695.320	99,9
17	Tirane Jug	2.600.000	2.538.009	97,6
18	Tirane2	1.400.000	1.400.000	100,0
19	Tirane Rurale	5.400.000	4.972.818	92,1
20	Zonat Turistike	1.200.000	941.962	78,5
21	Kamez Vore	5.000.000	4.940.051	98,8
22	D. Pergjithshme	20.374.614	20.370.601	100,0
	TOTALI	82.930.130	79.544.147	95,9

Shpenzimet operative faktike gjatë 12 mujorit të vitit 2018, janë realizuar në rreth 95.9% të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, në janar të vitit 2018, janë paraqitur të argumentuara në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë **kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme**, për drejtoritë e varësisë dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej 460 punonjësish. Për nevoja të institucionit, u ndoq e njëjta procedurë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2018 duke u shtuar një kontigjent prej 150 punonjësish me kontratë, në varësi të arkëtimit të të ardhurave.

Drejtoritë e varësisë, për plotësimin e nevojave për paga e sigurime për punonjësit me kontratë të përkohshme si dhe shpenzime operative, përdorin edhe fonde nga të ardhurat që realizohen. Të ardhurat e përdorura për përballimin e shpenzimeve korente kanë qënë 142.112.856 lekë, dhe me të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Drejtoria	Paga dhe sigurime shoqerore (punonjesit me kontrate të përkohshme)	Mallra dhe sherbime
1	Berat	1.821.464	0
2	Diber	840.235	643.121
3	Durres	9.041.342	2.001.896
4	Elbasan	7.042.179	3.010.160
5	Fier	6.579.240	61.960
6	Gjirokaster	2.213.817	371.793
7	Kavaje	3.912.620	942.830
8	Kruje	2.393.720	0
9	Korce	4.732.112	935.608
10	Kukes	106.863	824.000
11	Lezhe	4.817.791	2.952.655
12	Lushnje	3.110.163	0
13	Shkoder	4.819.851	499.800

14	Vlore	10.139.167	4.607.489
15	Sarande	3.578.503	299.480
16	Tirane Veri	9.555.273	2.114.377
17	Tirane Jug	10.341.127	1.474.066
18	Tirane2	6.453.831	2.000.000
19	Tirane Rurale	8.287.017	1.247.893
20	Zonat Turistike	3.596.125	225.552
21	Kamez Vore	10.864.896	1.793.548
22	D. Pergjithshme	0	897.275
	TOTALI	114.247.336	26.903.503

Brenda totalit të shpenzimeve të përgjithshme (buxhet+ të ardhura), shpenzimet "Mallra dhe shërbime" zënë 15.22%, ndërsa në vetvete 33.8% e tyre janë përballuar nga të ardhurat e realizuara.

Sipas zërave përbërës të tyre, shpenzimet korente janë realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Artikulli	Emërtimi	Buxheti 2018			Buxheti/Te Ardhura	
		Plan	Fakt	Në %	Fakt	
600	Shpenzime personeli Paga	429.662.870	417.422.876	97.15	95.555.502	512.978.378
601	Shpenzime personeli-sig.shoq.	66.508.000	64.946.709	97.70	19.647.918	84.594.627
602	Shpenzime operative	82.929.130	78.919.147	95.16	27.528.503	106.447.650
603-606	Të tjera shpenzime korrente	585.424	576.813	98.53		576.813
	Shpenzime korente	579.685.424	561.865.545	96.94	142.731.923	704.597.468

b. Investimet

Per vitin 2018, programi "Investimet publike me financim të brendshëm" është monitoruar në mënyrë të veçantë, dhe realizimi i tij është ndjekur me raportim mujor të veçantë dhe së bashku me atë të performancës së shpenzimeve buxhetore, duke evidentuar edhe fazat e veçanta në të cilat ndodhet shpenzimi.

Realizimi i këtij programi për këtë vit është në masën 92%, më i detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emri i Institucionit	Buxheti 2018	Vlera Totale e Kontratës	Realizimi ne %
Drejtoria e Pergjithshme	13.442.000	13.119.436	97.6
ALUIZNI - Tirana Veri	800.000	717.780	90
ALUIZNI - Zonat Turistike	800.000	0	0
TOTALI	15.042.000	13.837.216	92

Realizimi zë për zë i këtyre fondeve është analizuar me njësitë shpenzuese përkatëse për të zbuluar arsyet e mosrealizimit. Në njësitë shpenzuese janë kryer procedurat e prokurimit sipas përcaktimeve të LPP. Sqarohet se fondet për dy drejtorite rajonale u alokuan në mes të muajit dhjetor, gjë që nuk la hapësirë për riprokurim dhe c'ngurtesimi i tyre u bë në fillim të 2019.

c. Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimeve

Gjatë 12 mujorit të vitit 2018, Drejtoritë e ALUIZNI-t kanë realizuar të ardhura nga procesi i legalizimit nga vlera e parces ndertimore, tarifa e shërbimit dhe penaltitetet. Të ardhurat e realizuara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	DREJTORIA	Vlera e Parces ndertimore	Arketime nga tarifa e shërbimit	Arketime nga penaltitete
1	Berat	12,403,422	2,560,000	234,388
2	Diber	3,968,471	1,144,000	67,386
3	Durres	117,327,807	3,473,160	4,213,846
4	Elbasan	93,344,807	3,683,400	219,471
5	Fier	30,228,603	1,572,000	1,781,229
6	Gjirokaster	19,989,701	1,312,000	1,907,496
7	Korce	16,085,122	2,540,000	5,073,981
8	Kukes	14,760,149	672,000	168,153
9	Lezhe	22,283,300	3,544,000	3,246,690
10	Lushnje	19,469,578	1,056,000	2,712,612
11	Shkoder	27,877,922	1,534,000	7 624,962
12	Sarande	54,135,523	3,044,000	10,043,102
13	Vlore	139,526,969	3,760,000	6,923,588
14	Tirane Veri	244,243,554	1,120,000	1,000,136
15	Tirane 2	46,460,891	3,555,620	16,443,059
16	Tirane Rurale	18,642,705	3,784,000	20,252,957
17	Zona Turistike	65,213,878	4,315,343	660,462
18	Kamez-Vore	153,336,134	3,026,000	4,109,117
19	Tirana jug	160,428,395	2,199,123	1,407,971
20	Kruje	4,205,048	587,378	1,504,823
21	Kavaje	38,830,827	1,912,000	1,192,995
	TOTALI	1,302,762,456	50,394,024	90,788,574

Vlen të theksohet se këto janë të dhëna të dërguara nga Drejtoritë e varësisë për Vitin 2018, të cilat janë të rakorduara me degët përkatëse të thesarit.

Gjatë vitit 2018 janë transferuar në fondin e kompensimit të pronarëve **917.734.596 Lekë** nga të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndertimore të objekteve pa leje.

Janë arkëtuar në total 1.444.642.541 lekë nga 1.150.000.000 lekë të parashikuar për tu arkëtuar.

Janë shpenzuar nga drejtoritë e varësisë për paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative 142.731.923 lekë, si dhe mbeten për tu derdhur në buxhet të **ardhura të papërdorura në vlerë 214.176.010 lekë.**

Edhe për vitin 2018 është punuar në çdo drejtori për arritjen e objektivave të vendosura në PBA, punë e cila ka çuar në tejkalimin e tyre, ku nga 1 miliard lekë të caktuara në objektivat tona për arkëtimet nga vlera e parcelës ndërtimore janë realizuar 1.302.762.456 lekë, dhe nga 700.000.000 lekë të caktuara në objektivat tona për tu derdhur në buxhet u arrit në shifrën 917.734.596 lekë.

3. Infrastruktura dhe ambientet.

Gjendja e ambienteve të punës së drejtorive të ALUIZNI-t paraqitet jo e mirë. Ka mungesë të hapësirave në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme. Kjo ka bërë që në Arkivin qendror, nuk janë depozituar dosjet e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi që nga viti 2013.

Gjithashtu, hapësirat e ambienteve të punës, në shumë prej drejtorive janë të kufizuara dhe një pjesë e tyre janë detyruar të sistemohen në ambiente me qira, në pamundësi për të gjetur ambiente të përshtatshme shtetërore. Siperfaqet e zyrave dhe pronesia e tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	ALUIZNI	Pronësia	Sipërfaqe Totale në m2	Vlera mujore e qirasë	Gjendja e hapësirave
1	Berat	Prefektura	110	0	Ka nevojë për hapësira
2	Diber	Qira	240	40,000	
3	Durrës	Bashkia	335	0	Ka nevojë për hapësira
4	Krujë	D.Rajonale Bujqesise	232	0	Gjendja e mirë
5	Elbasan	Min. Drejtësisë	672	0	Gjendja e mirë
6	Fier	Administrim ALUIZNI	422		
7	Lushnje	Bashkia	131	0	Ka nevojë për hapësira
8	Gjirokastrë	Qira	192	45,900	Ka nevojë për hapësira
9	Korçë	Qira	175	60,000	Ka nevojë për hapësira
	Pogradec	Bashkia	49,1	0	Ka nevojë për hapësira
10	Kukës	Prefektura	86	0	Ka nevojë për hapësira
11	Lezhë	Qira	436	152,400	Ka nevojë për hapësira
12	Shkoder	Qira	540	120,000	Ka nevojë për hapësira
13	Sarandë	Qira	205	82,000	Ka nevojë për hapësira
14	Vlorë	D.Arkivave	467	0	Ka nevojë për hapësira
15	Tirana veri	Administrim ALUIZNI	535		
16	Tirana jug	Administrim ALUIZNI	545		
17	Tirana 2	Administrim ALUIZNI	320		
18	Tirana rurale	Qira	246	250,250	Ka nevojë për hapësira
19	Kamez vore	Qira	548	220,000	Ka nevojë për hapësira
20	Kavaje	Qira	212	58,823	Ka nevojë për hapësira
21	Zonat turistike	Administrim ALUIZNI	340		Ka nevojë për hapësira

Institucioni ynë është në prag të riorganizimit, dhe kjo ka qënë arsyeja për të cilën nuk është vepruar për ndryshime lidhur me ambientet e punës.

Në kuadër të platformës së bashkëqeverisjes për komunikim dhe ndërveprim me qytetarët, megjithë mungesën e hapësirave, ambientet e pritjes së qytetarëve kanë

qënë gjithmonë në vëmendje duke i dhënë rëndësi të veçantë, me hapësira të dedikuara, stola pritje, sinjalistikë dhe tabela informuese.

Nga inspektimet e kryera në të gjithë zyrat e pritjes në drejtoritë e varësisë, **problematika kryesore është ajo e hapësirave shumë të vogla në dispozicion.** Me fondet modeste që kanë në dispozicion drejtoritë, për shërbime nga buxheti i shtetit në llogarinë 602, janë realizuar lyerja dhe sistemimi i tyre me pajisje zyre.

Problematikë është edhe numri i vogël i automjeteve në dispozicion të drejtorive, vetëm 12 nga 21 drejtori dhe 85% e tyre janë tërësisht të amortizuara. Të dhëna më të detajuara për autojmetet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Numri	Gjendja teknike
1	Berat	0	
2	Diber	0	
3	Durres	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
4	Kruje	0	
5	Elbasan	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
6	Fier	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
7	Lushnje	0	
8	Gjirokaster	0	
9	Korçe	0	
10	Kukes	0	
11	Lezhe	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
12	Shkoder	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
13	Sarande	0	
14	Vlore	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
15	Tirana veri	1	E mire
16	Tirana jug	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
17	Tirana 2	1	E mire
18	Tirana rurale	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
19	Kamez vore	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit
20	Kavaje	0	
21	Zonat turistike	1	Amortizuar ne procedure per jashte perdorimit

4. Prokurimet publike.

Në zbatim të LPP, drejtoritë e ALUIZNI-t kanë kryer procedura prokurimi për mallra e shërbimet që i nevojiten për kryerjen e aktivitetit. Gjatë vitit 2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t dhe 21 drejtoritë e saj të varësisë janë zhvilluar 289 procedura prokurimi.

Janë lidhur kontrata në vlerën 56,485,993 Lekë me TVSH, nga të cilat 16.035.012 lekë ose 28% e tyre janë përballuar me të ardhurat e realizuara nga vet drejtoritë.


Ndër këto procedura, numrin më të madh e zënë ato me objekt kancelari, letër dhe tonera.

Ndërsa nevojat për ruajtjen e objekteve janë zgjidhur në mënyra të ndryshme, në varësi të objektit dhe buxhetit në dispozicion. Në 14 drejtori nuk janë kryer shpenzime për këtë zë. Në 5 drejtori janë kryer procedura prokurimi me vlerë të vogël. Vetëm në 3 drejtori shpenzimet për këtë shërbim kanë kaluar vlerën e përcaktuar për prokurimin me vlerë të vogël, duke kryer procedurë « Kërkesë për propozim ».

BURIMET NJERËZORE, REKRUTIMET DHE ECURITË DISIPLINORE.

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, funksionon me Urdhrin nr. 58, 05.04.2016 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe drejtorive në varësi të saj". Numri i përgjithshëm i punonjësve të ALUIZNI-t, sipas strukturës së miratuar është 315.

Për vitin 2018 Institucioni, në respektim të dispozitave të Kodit të Punës, për punonjësit e strukturës dhe ata me kontratë të përkohshme, ka dhënë gjithsej 309 masa disiplinore, nga të cilat, 9 "Largim nga puna", 6 "Ulje në detyrë", 1 "Pezullim i përkohshëm", 48 "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", 86 "Vërejtje me shkrim", 91 "Vërejtje", dhe 68 "Tërheqje vëmendje".



Një problematikë me të cilën përballemi në vazhdimësi dhe, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni, është cilësia e burimeve njerëzore.

Duke vlerësuar sa më sipër, gjatë vitit 2018 i është dhënë përparësi rritjes së nivelit profesional të punonjësve. Janë hartuar programet e trajnimit në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Një rëndësi e veçantë i është dhënë zhvillimit të trajnimeve të brendshme me karakter të posaçëm, që lidhen me kryerjen e detyrave të veçanta të punonjësve apo sektorëve të ndryshëm të Drejtorive të varësisë së ALUIZNI-t, në përgjigje të kërkesave të Drejtorive Varësisë në lidhje me aspekte të veçanta të aktivitetit të tyre. Numri total i pjesëmarrjes në trajnimet e organizuar nga vetë ALUIZNI apo në bashkëpunim me institucionet e tjera është mbi 370 të trajnuar.

E. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIT TË BRENDSHËM.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", Sektori i Auditit të Brendshëm, ka synuar të përfshijë ato subjekte, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ato ushtrojnë veprimtarinë administrative.

Veprimtaria audituese është orientuar në auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit, me qëllim funksionimin në mënyrë eficiente dhe me kosto efektive, në arritjen e objektivave.

Sipas Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2018, (nr.7706, datë 17.10.2017), miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, është parashikuar kryerja e auditimeve të plota. Gjatë vitit 2018, janë dhënë gjithsej **52 rekomandime**, të cilat prekin, sistemet e tjera sipas misionit, si dhe janë realizuar **5 auditime të plota, dhe 14 auditime të pjeshme (tematike), nga të cilat janë rekomanduar marrja e 32 masave disiplinore dhe administrative.**

Proçesi i planifikimit ka vijuar të përmirësohet, duke shfrytëzuar eksperiencat e viteve të mëparshme, si dhe duke respektuar me profesionalizëm standartet e auditimit të brendshëm në fushën e planifikimit.

Sektori i Auditit të Brendshëm e ka orientuar përdorimin e burimeve të auditimit drejt fushave me risk të lartë, duke orientuar njësinë drejt përmbushjes së objektivave me kosto sa më të ulët, me qëllim kontribuimin në arritjen e objektivave në kuadër të përmbushjes së detyrimeve dhe të angazhimeve në luftën kundër korrupsionit për vitin 2018, dhe programeve strategjike të sistemit financiar publik.

Sektori i Auditimit të Brendshëm do të vijojë të përmirësojë eficientësinë dhe do të rrisë asistencën profesionale në ndihmë të përmirësimit të drejtimit dhe shtimit të vlerës së ALUIZNI-t dhe të njësisë në vartësi të saj, duke planifikuar për auditim ato struktura varësie, aktivitete apo fusha me risk të lartë, pa lënë mënjanë edhe strukturat e tjera të varësisë.

Gjatë periudhës 1 vjeçare, janë shqyrtuar rreth 231 kërkesa/ankesa nga qytetarët, nga të cilat janë bërë 58 verifikime ku janë mbajtur Akt-Konstatimet përkatëse, duke lënë edhe rekomandime për zgjidhjet më të shpejta dhe efikase, në ndihmë të qytetarit dhe specialistëve të drejtorisë.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë drejtorive të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për vitin 2018, janë dhënë **rekomandime për përmirësimin e sistemit, kryesisht në procesin e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve informale, miratimit të lejeve të legalizimit, sistemit të pagave, sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.** Këto rekomandime janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim dëmi. Proçesi i monitorimit dhe sigurimi i cilësisë së AB në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, ka qenë e një niveli të kënaqshëm. Gjatë hartimit dhe mbajtjes së programit të auditimit kemi siguruar që cilësia e auditimeve të kryera të jetë e një niveli të mirë të specialistëve të këtij sektori. Auditimi i brendshëm

është kryer në bazë të standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit të brendshëm, dhe manualit të Auditit të Brendshëm.

Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është edhe monitorimi dhe rishikimi i jashtëm i veprimtarisë audituese ku Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ka kryer trajnimet e përvitshme dhe të vazhdueshme në lidhje me standardet e AB si dhe të kontrollit të brendshëm.

II. OBJEKTIVAT

Bazuar në *"Deklaratën e Politikave të Programit Buxhetor për vitin 2019"*, dhe parashikimet në buxhetin e vitit 2019 është përcaktuar si objektiv legalizimi i **25.000** ndërtimeve informale. Ky parashikim është bazuar në logjikën e një normative të përcaktuar mujore të miratimit të lejeve të legalizimit, e cila varion nga **2.000-3.000** leje legalizimi në muaj.

Ndërkaq, me ndryshimet në ligjin 9632 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, është parashikuar se, *"Leja e legalizimit miratohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi"*.

Ky amendim i ligjit, i cili shton hapat procedurale të miratimit të lejes së legalizimit, pritet të ndikojë ndjeshëm në kohën e përmbylljes së procesit administrativ, duke **kushtëzuar** miratimin e lejes së legalizimit me veprimtarinë e njësive të vetqeverisjes vendore, si dhe vullnetin e vetë subjekteve mbi shlyerjen në kohë të detyrimeve financiare që vijnë si pasojë e aplikimit të kësaj takse (njoftimi njësive të vetqeverisjes vendore dhe i subjektit nga ALUIZNI, përlogaritja e taksës dhe paraqitja e saj subjektit nga njësitet e qeverisjes vendore, lëshimi dhe administrimi i vërtetimit nga këto institucione pas shlyerjes së detyrimit).

Si rrjedhojë, pritet që normativa mujore të ulet në **800-1.000** leje legalizimi, çka do të sjellë edhe uljen e numrit të pritshëm të lejeve të legalizimit për vitin 2019 në rreth **10.000**.